


ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE NË QARKUN DURRËS

Në zbatim të ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Vendimit nr.593 datë 09.10.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore", Rregullores nr. 01 datë 13.06.2022; Prefekti i Qarkut Durrës në rolin dhe cilësinë e Kryetarit të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura në qarkun, ndjek, koordinon dhe bashkërendon punën për menaxhimin e zonve të mbrojtura mjedisore në qarkun Durrës.

Administratën Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka nën administrim dhe menaxhim këto zona të mbrojtura:

1. Parku Natyror “Qafështamë”, Kategoria IV, me sipërfaqe 6864.36 ha, shpallur me VKM-në Nr. 60, datë 26.01.2022
2. Peizazh i Mbrojtur “Krastë-Verjón” me sipërfaqe 1470.1 ha, shpallur me VKM nr. 595, datë 25.09.2024
3. Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor “Rrushkull” me sipërfaqe 579.5 ha, shpallur me VKM nr. 589, datë 25.09.2024
4. Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor “Bisht – Kamzë” me sipërfaqe 491.5 ha, shpallur me VKM nr. 592, datë 25.09.2024
5. Parku Kombëtar “Mali i Dajtit”, nga të cilat 2444 ha në administrim të AdZM Durrës, shpallur me VKM-në Nr. 59, datë 26.01.2022
6. AdZM Durrës ka në administrim dhe 18 Monumente Natyre, të shpallura me VKM nr. 187, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa”, të VKM nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”.



1. Parku Natyror “Qafështamë”

Shpallur për herë të parë si zonë e mbrojtuar e kategorisë Park Kombëtar miratuar me VKM nr. 102, datë 15.01.1996, me sipërfaqe 2000 ha. Sot, Parku Natyror “Qafështamë”, Kategoria IV, me sipërfaqe 6864.36 ha, shpallur me VKM-në Nr. 60, datë 26.01.2022 “Për shpalljen e Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV), si dhe Miratimin e Ndryshimit të Statusit e të Sipërfaqeve ekzistuese të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”, Aneksi 5. Parku është propozuar gjithashtu si pjesë e rrjetit EMERALD (Zonat me Interes të Veçantë për Mbrojtje të Evropës).

Kjo zonë përfshin sipërfaqe me pyje, bujqësore, shkurre dhe inproduktive. Mbulesa e tokës brenda sipërfaqes së Parkut Natyror “Qafështamë”, jepet në Tabelën 1 më poshtë:

Tabela 1. Sipërfaqja e PN-së e përshkruar sipas mbulesës.

Mbulesa	Sip. Në ha	Përqindja
Pyje	2228.3	32.46
Sipërfaqe heterogjene bujqësore	684	9.96
Sipërfaqe pa/ose me vegjetacion të pakët	866.5	12.62
Bujqësore	13.2	0.19
Urbane	160.06	2.33
Shkurre & Bimësi barishtore	2912.3	42.43
Total	6864.36	100.00

Parku Natyror “Qafështamë”, ndahet në dy nënzona ruajtje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Nënzona Qëndrore, me sipërfaqe 2883.95 (dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre presje nëntëdhjetë e pesë) ha, e shënuar në hartë me ZQ.

Kjo nënzona përfshin habitatet kryesore pyjore, shkurre dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta e të rralla për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë.

b) Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, me sipërfaqe 3980.41 (tre mijë e nëtëqind e tetëdhjetë presje dyzetë e një) ha, e shënuar në hartë me ZPTQ.

Kjo nënzona përfshin tokat pyjore, bujqësore e kullotat, dhe territore ujore ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale si punime për shëndetësimin e pyjeve, aktivitete bujqësore, kullotja, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë ekonomike që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit natyror.

Në nënzona e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm, zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk


cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

Zonimi dhe sipërfaqet në Parkun Natyror “Qafështamë” jepen në Tabelën 2.

Tabela 2. Zonimi i brendshëm i PN-së.

Zonimi	Sipërfaqe ha	Përqindja
Zona qendrore	2883.95	42.01
Zona e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm	3980.41	57.99
Totali	6864.36	100.00

Figura 1. Harta e PN “Qafështamë”



2. Peizazhi i Mbrojtur “Krastë – Verjon”


Shpallur për herë të parë si zonë e mbrojtur e kategorisë Peizazh i Mbrojtur “Krastë-Verjon”, me VKM nr. 468, datë 26.07.2018 me sipërfaqe 1469.239 ha. Sot, Peizazh i Mbrojtur “Krastë-Verjon” me sipërfaqe 1470.1 ha, shpallur me VKM nr. 595, datë 25.09.2024, “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur” (Kategoria V) të zonës “Krastë - Verjon”.

Zona brenda këtij ekosistemit natyror përfshin sipërfaqe me pyje, bujqësore, heterogjene bujqësore, shkurre, kullota, inproduktive, ujore dhe zonë urbane. Mbulesa e tokës brenda sipërfaqes së Peizazhit të Mbrojtur “Krastë – Verjon”, jepet në Tabelën 3 më poshtë:

Tabela 3. Sipërfaqja e peizazhit e përshkruar sipas mbulesës.

Mbulesa	Sip. në ha	Përqindja
Pyje	154.2	10.49
Sipërfaqe heterogjene bujqësore	32.7	2.22
Sipërfaqe ujore	67.8	4.61
Sipërfaqe pa/ose me vegjetacion të pakët	122.6	8.34
Kullota	36.7	2.50
Bujqësore	343.5	23.37
Shkurre	692.7	47.12
Zona urbane	19.8	1.35
Total	1470.1	100.00

Figura 2. Harta e peizazhit të mbrojtur “Krastë–Verjon”



3. Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor “Rrushkull”


Shpallur për herë të parë Rezervat Natyror i Menaxhuar “Rrushkull” nga Rregullorja nr. 1, datë 27.07.1977 e Ministrisë së Bujqësisë, me sipërfaqe 650 ha. Sot, Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor “Rrushkull” me sipërfaqe 579.5 ha, shpallur me VKM nr. 589, datë 25.09.2024, “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të zonës “Rrushkull”.

Kjo zonë përfshin sipërfaqe me pyje, bujqësore, heterogjene bujqësore, shkurre, kënetore, inproduktive dhe ujore detare. Mbulesa e tokës brenda sipërfaqes së Peizazhit të Mbrojtur “Rrushkull”, jepet në Tabelën 4 më poshtë:

Tabela 4. Sipërfaqja e PM-së, e përshkruar sipas mbulesës.

Mbulesa	Sip. në ha	Përqindja
Bujqësore	22.6	3.9
Pyje	297.0	51.3
Sipërfaqe heterogjene bujqësore	0.9	0.2
Sipërfaqe ujore detare	2.5	0.4
Sipërfaqe kënetore	253.7	43.8
Sipërfaqe pa/ose me vegetacion të pakët	2.8	0.5
Total	579.5	100.0

Figura 3. Harta e Peizazhit të Mbrojtur Ujor/Tokësor “Rrushkull”



4. Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor “Bisht – Kamzë”


Shpallur për herë të parë Peizazhi i Mbrojtur Ujor/Tokësor “Bisht – Kamzë” me sipërfaqe 491.5 ha, shpallur me VKM nr. 592, datë 25.09.2024, “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të zonës “Bisht - Kamzë”.

Kjo zonë përfshin sipërfaqe me pyje, shkurre, kullota, bujqësore, kënetore, inproduktive, ujore detare si dhe zona urbane. Mbulesa e tokës brenda sipërfaqes së Peizazhit të Mbrojtur Ujor/Tokësor “Bisht-Kamzë”, jepet në Tabelën 5 më poshtë:

Tabela 5. Sipërfaqja e PM - së e përshkruar sipas mbuleses

Mbulesa	Sip. në ha	Përqindja
Bujqësore	3.2	0.65
Pyje	133.0	27.07
Sipërfaqe heterogjene bujqësore	28.3	5.76
Sipërfaqe ujore detare	33.9	6.90
Sipërfaqe kënetore	107.0	21.77
Sipërfaqe me vegjetacion të pakët	102.0	20.75
Kullota	6.9	1.41
Shkurre	77.0	15.67
Zona urbane	0.1	0.03
Total	491.5	100.00

Figura 4. Harta e Peizazhit të Mbrojtur Ujor/Tokësor “Bisht-Kamzë”



5. Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” (2444 ha në administrim të AdZM Durrës)

Shpallur për herë të parë Parku Kombëtar “Mali i Dajtit”, me VKM nr. 402, datë 21.06.2006 dhe ndryshuar me vonë me VKM nr. 715, datë 23.06.2009 me sipërfaqe 29384.18 ha. Sot, Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” me sipërfaqe 28561.84 ha, nga të cilat 2444 ha në administrim të AdZM Durrës, shpallur me VKM-në Nr. 59, datë 26.01.2022 “Për Miratimin e Ndryshimit të Statusit dhe Sipërfaqes së Ekosistemeve Natyrore “Park Kombëtar” (Kategoria II) e zonave të mbrojtura mjedisore”, Aneksi 5. Parku është propozuar si pjesë e rrjetit EMERALD (Zonat me Interes të Veçantë për Mbrojtje të Evropës).

Përkatësisht në administrim të AdZM Durrës ndodhet Ekonomia Pyjore Bruz-Rrëzë, sipërfaqja 2444 ha, nga këto 1550 ha fond pyjor. Kufizohet: nga Jugu me rrethin e Tiranës (Bovilla), nga Veriu PN “Qafështamë”, nga Perëndimi Mali i Gamtit, Rrethi i Tiranës, nga Lindja rrethi i Matit.

Zona brenda këtij ekosistemit natyror përfshin pyje, bujqësore, shkurre, kullota, sipërfaqe heterogjene bujqësore, sipërfaqe me vegjetacion të pakët, bimësi barishtore, zona urbane dhe sipërfaqe ujore. Mbulesa e tokës brenda sipërfaqes së Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”, jepet në Tabelën 6, si më poshtë vijon:

Tabela 6. Sipërfaqja e PK-së, e përkthyer sipas mbulesës.

Mbulesa	Sip. në ha	Përqindja
Pyje	12555.9	43.96
Sipërfaqe heterogjene bujqësore	4419.8	15.47
Sipërfaqe ujore	422.1	1.48
Sipërfaqe me vegjetacion të pakët	2839.2	9.94
Kullota	142.6	0.50
Bujqësore	489.26	1.71
Shkurre & Bimësi barishtore	7490	26.22
Zona urbane	202.98	0.71
Total	28561.84	100

Ekosistemi natyror “Mali i Dajtit”, shpallur me status “Park Kombëtar” ndahet në tre nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Nënzona Qëndrore, me sipërfaqe 9794.48 (nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër presje) ha, e shënuar në hartë me ZQ.

Kjo nënzona përfshin habitatet kryesore pyjore (pyje të lartës, cungishte dhe shkurre) dhe përcaktohet si zonë me vlera të larta e të rralla për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e më lartë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzona lejohen, kërkimi shkencor dhe zhvillimi i veprimtarive ekoturistike të lira në natyrë.

b) Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, me sipërfaqe 17183.78 (shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre presje shtatëdhjetë e tetë) ha, e shënuar në hartë me ZPTQ.

Kjo nënzona përfshin tokat pyjore, bujqësore e kullotat, dhe territore ujore ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale si punime për shëndetësimin e pyjeve, aktivitete bujqësore, kullotja, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë ekonomike që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit natyror. Në nënzonen e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm, zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk çenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

c) Nënzona e Rekreacionit me sipërfaqe 1583.58 (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre presje pesëdhjetë e tetë) ha, e shënuar në hartë me ZR.


Në këtë zonë përfshihen pjesë nga habitatet pyjore dhe ato ujore dhe në këtë zonë zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive turistike, si mundësi shëtitje në natyrë, shërbime turistike në mënyrë të tillë që respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat e tij ekologjike dhe ato të peizazhit natyror, në mbështetje të studimeve urbanistike të miratuar nga KKT-ja.

Zonimi dhe sipërfaqet në Parkun Kombëtar “Mali i Dajtit” jepen në Tabelën 7.

Tabela 7. Zonimi i brendshëm i PK-së.

Zonimi	Sip. në ha	Përqindja
Zona qendrore	9794.48	34.29
Zona e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm	17183.78	60.16
Zona e rekreacionit	1583.58	5.54
Total	28561.84	100

Figura 5. Harta e Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”



6. Monumentet e Natyrës

AdZM Durrës ka në administrim dhe 18 Monumente Natyre, të shpallura me VKM nr. 187, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa”, të VKM nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”. Në tabelën nr. 8 gjendet lista e MN, sipas bashkive të qarkut Durrës.

Tabela 8. Lista e MN të qarkut Durrës, sipas bashkive.

Qarku	Bashkia	Numri i MN	MN
Durrës	Durrës	4	Kepi i Rodonit
			Plazhi i Kallmit
			Pylli i Kolndrekajve (Nuk egziston)
			Shkëmbi i Kavajës
	Tiranë	1	Gështenja e Bazanxhajt
	Krujë	11	Gryka e Vajës ose Shkëmbi i Vajës
			Gryka e Zezë
			Kroi i Nënës Mbretëreshë
			Masi i pishës së zezë Qafshatamë
			Rrapi i Ballabanecit
			Rrapi i Buranit
			Rrapi i Taslloit
			Rrapi Kryeshkozë
			Rrepet e Arramerasit (Fushë Krujë)

			Sarisalltiku dhe shpella
			Selvia e Teqesë (Fushë Krujë)
	Shijak	2	Çinari i Balliasit (Nuk egziston)
			Rrapi i Rubjekës (Nuk egziston)
	Totali	18	

➤ **Kuadri Ligjor për Zonat e Mbrojtura**

- Ligj nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, i ndryshuar
- Vendime të Këshillit të Ministrave
- Rregullore, Udhëzime

➤ **Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura**

Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura ngrihet dhe funksionon në zbatim të ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Vendimit nr.593 datë 09.10.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore", Rregullores nr. 01 datë 13.06.2022.

Sipas VKM-së Nr. 593, datë 9.10.2018 “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore”:

- Komiteti i menaxhimit drejtohet nga Prefekti, i cili është kryetar i tij.
- Funksioni i Komitetit është menaxhimi i zonave të mbrojtura në zbatim të ligjit. Mënyra e funksionimit përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Komiteti i Menaxhimit për Zonat e Mbrojtura Qarku Durrës, Rregullore nr. 01 datë 13.06.2022.
- Komiteti i menaxhimit e ushtron veprimtarinë nëpërmjet mbledhjeve të zakonshme dhe thirret nga Prefekti jo më pak se dy herë në vit.

Çështjet kryesore ku bazohen diskutimet gjatë mbledhjeve janë: aktivitetet e paligjshme (guroret, furrat e gëlqeres), zjarret, ndërtimet pa leje, infrastruktura rrugore, rivitalizimi, aksionet e pastrimit, gjuetia e paligjshme dhe monumentet e kulturës, ruajtja e florës dhe faunës në këto zona të mbrojtura mjedisore.

Për të gjitha problematikat e ngritura gjatë mbledhjeve lihen detyra konkrete për strukturat përgjegjëse në mënyrë që të marrin zgjidhje.

Vëmendja e punës së këtij Komiteti dhe në mënyrë të veçantë e Ad.Z.Mbrojtura Durrës Krujë ka qenë në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm për mbrojtjen dhe menaxhimin e ZMM-re, parandalimin e aktiviteve të paligjshme në to, në mënyrë të veçantë në drejtim të mbrojtjes së tyre nga ndërtimet pa leje; në lidhje me shfrytëzimin e gurores nga shoqëritë e shfrytëzimit të tyre; mbrojtjen nga zjarri, apo edhe pyllëzimit të zonave të mbrojtura.

Nisur nga këto aspekte në rolin edhe të drejtuesit të Komitetit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore,

Prefekti i Qarkut gjatë vitit 2024 ka zhvilluar dy takime me strukturat përgjegjëse pjesë të Komitetit, ka patur korendiment të ndryshme në lidhje me koordinimin e punës dhe veprimin në zbatim të ligjit në këto zona të mbrojtura.

Si rezultat i koordinimit, bashkërendimit dhe punës së Komitetit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore gjatë vitit 2024 në Zonat e Mbrojtura Mjedisore janë ndjekur dhe realizuar këto detyra si dhe rezultojnë këto të dhëna:

- Nga strukturat e Adm.Z.Mbrojtura Janë hartuar 12 procesverbale për periudhën Janar - Dhjetor 2024:
 - 2 procesverbale janë për riaktivizimin e furrave të gëlqeres;
 - 1 procesverbal për prerje në PN “Qafështamë”;
 - 1 procesverbal për prerje në PM “Krastë – Vrion”;
 - 1 procesverbal për prerje në “Gatri i Bruzit” në PK “Dajt”;
 - 1 procesverbal për ndotje në PM “Krastë – Verjon”;
 - 2 procesverbale për subjekte private;
 - 1 procesverbal për gjurmim në Bovillë pjesë e PK “Dajt”;
 - 3 procesverbale për zjarre, një në PN “Qafështamë” (përshkruar 0.1 ha shkurre) dhe dy në PM “Krastë - Verjon” (në rastin e parë përshkruar 9.5 ha pyje dhe djegur 4.5 ha trungishte të llojit pishë e egër, ndërsa në rastin e dytë përshkruar 0.5 ha shkurre);
 - Gjatë vitit 2024 nuk ka patur ndërtime paleje dhe raste të gjuetisë së paligjësme në zonat e mbrojtura mjedisore.
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë realizuar 9 fushata të suksesshme mjedisore ku konkretisht përfshijnë mbjelljen e 130 fidanëve në shkollë dhe 1550 fidanë në zonat e mbrojtura, duke përfshirë 1300 në Nuaj, PN “Qafështamë”. Përveç kësaj, janë mbjellë 100 fidanë në PM “Krastë-Verjon” dhe 50 fidanë në Bovillë, duke treguar një përqendrim më të madh te aktivitetet konkrete për rikuperimin e mjedisit.
- Orët edukative mjedisore kanë ndihmuar në ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe pjesëmarrjen aktive në aktivitete të dobishme si pyllëzimi. Në vitin 2024 numri i orëve të realizuara ishte 31 orë mjedisore.
- Gjatë vitit 2024 u zhvilluan 27 aktivitete pastrimi me një angazhim të shtuar për të përmirësuar hapësirat publike dhe natyrore përmes pastrimit dhe mirëmbajtjes së tyre.
- Numri i vizitorëve gjatë vitit 2024 ishte në total 384750 vizitorë, nga të cilët 314300 vendas dhe 70450 të huaj.

Objektivat e punës Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura dhe Adm.Z.Mbrojtura Durrës Krujë për vitin 2025 në drejtim të Zonave të Mbrojtura Mjedisore

1. Ndjekja, monitorimi, koordinimi dhe bashkërendimi i punës i të gjithë strukturave pjesë të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura në drejtim të zbatimit dhe respektimit të kuadrit ligjor në mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre zonave në mënyrë të qëndrueshme
2. Ndjekja dhe monitorimi i të gjithë problematikave që paraqiten në këto Zona të Mbrojtura si dhe dhënia e zgjidhjeve të tyre me strukturat përgjegjëse, apo orientimi i këtyre problematikave në strukturat qëndrore.

3. Ndjekja në mënyrë të vazhdueshme aksioneve të pastrimit në ZMM, të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së parqeve dhe pasurive natyrore si një domosdoshmëri në zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre zonave.
4. Shtimi i vëmendjes në drejtim të monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse për prani të guroreve aktive, furrave të gelqeres, ndërtimeve pa leje, si dhe nxitja e zhvendosjes së tyre nga ajo zonë për ta rehabilituar atë.
5. Ndërgjegjësimi i komunitetit në dhënien e informacionit dhe ndërhyrjen sipas rastit për eliminimin e zjarrit që të mos marrë përmasa më të mëdha si dhe në dhënien e informacionit pranë policisë në rast evidentimi të aktiviteteve të paligjshme.
6. Krijimin e kushteve për rritjen e sasisë së mbjelljeve të pemëve të reja, hapjen e shtigjeve të tjera turistike, rehabilitimin e infrastrukturës si dhe të mbrojtjes së faunës dhe florës.
7. Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në këto zona të mbrojtura për të krijuar një lidhje të ngushtë të njeriut me natyrën.